



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0913

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) MALSIJAJ COMPANY SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të KOMUNA E GJAKOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pajimet dhe sinjalizimi i trafikut rrugor” me numër të prokurimit 632-23-9062-1-1-1, me 12/01/2024, mori:

Vendim

- Hedhet si e palejuar**, ankesa e OE MALSIJAJ COMPANY SH.P.K. me nr. 2023/0913, e datës 17/11/2023, kurse mbetet në fuqi vendimi i AK KOMUNA E GJAKOVËS lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pajimet dhe sinjalizimi i trafikut rrugor” me numër të prokurimit 632-23-9062-1-1-1, si palë pa interes juridik material, konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së.
- Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
- Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale –

KOMUNA E GJAKOVËS , në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 25.08.2023, ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pajimet dhe sinjalizimi i trafikut rrugor” me numër të prokurimit 632-23-9062-1-1-1. Ndërsa me datë 01.11.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim dhe vlera e parashikuar e kontratës 240,000.00 €.

Me datë 06.11.2023, OE ankues ka bërë kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit të lartcekur të AK ndërsa me datë 07.11.2023 KOMUNA E GJAKOVËS refuzon si të pa pabazuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik.

Me datën 17.11.2023 OSHP ka pranuar ankesën nga OE MALSIJAJ COMPANY SH.P.K. me numër të protokollit 913/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pajimet dhe sinjalizimi i trafikut rrugor” me numër të prokurimit 632-23-9062-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE MALSIJAJ COMPANY SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi Ankuesi pretendon se “Këto më lartë janë dokumentacioni të cilin e ka bashkangjitur OE fitues si përgjigje ndaj kërkesës të juaj. Nga kjo shohim se prap mungon dëshmia e përshkrimit të karakteristikave të kësaj makine- makina tharëse e timpit W-JETP901WAS4-380, Përpos kësaj pika3 ku keni Kërkuar EN standardet të pajisjeve semaforike, nuk janë prezantuar fare. Janë prezantuar deklarata nga kompanitë autorizuese që posedojnë

këto standarde, Por dëshmi tjetër nuk kanë bashkangjitur. Kuptohet që për tu pajisur me standarde duhen plotësuar disa kushte. Edhe kjo vlen për një periudhë të caktuar. Dhe pasi përfundon ai afat, duhet ri aplikuar prap. Pra mungon certifikata e standardeve, ku shihet nga kush jon certifiku kompanitë autorizuese, në qfarë periudhe etj.-dhe për këtë AK në vendim të datës ka thënë se një deklaratë e cila përshkruan se Kompania posedon EN standardet është sipas Kërkesës. Që i bie së një deklaratë ku përshkruhet se ti posedon en standarde është e barasëvlefshme me certifikata të EN standardeve. Pyetja është pasi që me një deklaratë mund ti mbulojmë EN standardet atëherë pse me apliku për to, dhe të krijojmë shpenzime të panevojshme Gjithashtu kemi vërejtur që autorizimet janë identike në përpilimin e fjalive. Qe na bënë përshtypje se vetëm një person ka përpunuar dhe lëshuar këto autorizime..”

Pretendimi i dytë (II): Ankuesi pretendon se “*Gjithësesi ne nuk pajtohemi me atë që është thënë në vendim as të datës 01.11.2023 dhe as atij të datës 07.11.2023, ne i plotësojmë kushtet e kërkuara në DT. Duke përfshi të gjitha kriteret e kërkuara.*”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE MALSIJAJ COMPANY SH.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 2, 7, 59 dhe 72 të LPP duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 27/11/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 913/23, ndërsa me datë 08/12/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0913 me rekomandimet si në vijim: “*Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.*”

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesit e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE MALSIJAJ COMPANY SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0913 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) ankimor është pjesërisht i bazuar pasi që: “Eksperti sqaron se në kërkesën për sqarime, AK nga OE i rekomanduar ka kërkuar disa sqarime shtesë në lidhje me karakteristikat e makinës tharëse W-JETP901WAS4-380, EN standardeve të kërkuara dhe autorizimeve. OE ankues pretendon që këto sqarime prapë nuk i përmbushin kërkesat e DT-së. Nga sqarimet shtesë të dorëzuara nga OE i rekomanduar, shihet se sa i përket makinës tharëse, operatori ka dorëzuar një katalog përmes të cilit e sqaron kërkesën në DT që kjo makinë të ketë fuqi prej minimum 300Kw, OE i rekomanduar ka ofruar katalogun në të cilin tregohet fuqia e kësaj makine prej 350Kw, gjë që sipas ekspertit e përmbushë kërkesën e DT-së.

Sa i përket certifikatave të EN standardeve të kërkuara përmes kërkesës për sqarim, janë dërguar dy dokumente, deklarata konformiteti nga prodhuesit të cilët sqarojnë se produktet e tyre janë në përputhje me kërkesat dhe direktivat evropiane si dhe tregojnë edhe për llojin e EN standardeve me të cilat janë të pajisuara këto produkte, por prapë nuk është bashkëngjitur certifikata për këto standarde. Sipas ekspertit shqyrtues, këto deklarata të konformitetit nuk i përmbushin kriteret e kërkuara në DT, sepse sipas dosjes kërkohet që OE të kenë certifikatat e EN standardeve të cilat janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të Aneksi 1. Sipas mendimit të ekspertit, nuk është përmbushur kriteri i këtyre certifikatave.

Ndërsa sa i përket dyshimeve se autorizimet janë identike në përpilimin e fjalive, ky është një pretendim për të cilin eksperti shqyrtues nuk është i thirrur profesionalisht të jap përgjigje, nëse ka dyshime të falsifikimeve të dokumenteve të dorëzuara nga OE i rekomanduar, atëherë eksperti inkurajon OE ankues që rastin ta paraqes në organet kompetente të cilat merren me këto çështje.

Sa i përket pretendimit të dytë, OE ankues thjeshtë ka dhënë një përkrahje të përgjithshme se nuk pajtohet me arsyet e eliminimit të saj nga ky aktivitet prokurimi, mirëpo nuk ka dhënë asnjë

fakt apo detaj përmes të cilit ai sqaron dhe arsyeton se i ka përmbushur të gjitha kriteret e DT-së dhe se eliminimi i tij nuk është bërë në përputhje me LPP. Pa pretendime konkrete ankimore se ku OE ankues mendon se i është shkaktuar padrejtësi nga ana e AK-së, eksperti nuk mund të vlerësoj se a është bërë shkelje nga ana e Autoritetit Kontraktues apo jo.

Sipas të thënave si më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues mbështet në plotni raportin e ekspertit shqyrtues, pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës, ka gjetur se ankesa duhet të hedhet si e palejuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues vendos që aktivitetin e prokurimit “Pajimet dhe sinjalizimi i trafikut rrugor” me numër të prokurimit 632-23-9062-1-1-1 të mbetet në fuqi, të inicuar nga AK - Komuna e Gjakovës.

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër dhe rrjedhën e procedurës. Sikurse mund të kuptohet edhe nga përmbajtja e ankesës, apriori pretendimet ankimore nuk konsistojnë në faktin nëse është atakuar apo jo interesi ekonomik i Ankuesit. Prandaj parashtruesi i ankesës nuk mund ta ketë statusin e palës me interes në kuptim të paragrafit 1.26, të nenit 4 (Përkufizimet), të LPP, sipas të cilit palë e interesuar është personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit. Lidhur me këtë eksperti shqyrtues në raportin e ekspertizës së dt. 08.12.2023, e paraqet faktin se OE ankues në këtë aktivitet të prokurimit sipas letrës standarde të AK është i eliminuar për këtë aktivitet të prokurimit, dhe në ankesën e tij nuk e paraqet asnjë provë apo argument se oferta e tij është e përgjegjshme dhe nuk ka provuar se konstatimet e AK për eliminimin e tij/saj janë të paqëndrueshme. Dhe këtë nuk e ka bërë në asnjë shkresë tjetër, qoftë edhe në mendimin lidhur me raportin e ekspertizës që ka pasur afat prej 4 ditësh të shpreh në qoftë se ka kundërshtimet e tij/saj.

Paneli shqyrtues nuk lëshohet në konstatimet e pretendimeve ankimore ndaj të rekomanduarit për kontratë për shkak se pala ankimore nga ka provuar se është palë me interes dhe Paneli shqyrtues detyrohet ta marrë në konsideratë faktin parimor se, tenderi i ofruar nga OE ankues sipas AK është i papërgjegjëm në procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, i njoftuar zyrtarisht nga AK me anë të letrës standarde për tenderuesin e eliminuar dhe me anë të pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e tij nuk e provon të kundërtën dhe e atakon OE të rekomanduar për kontratë. Për këto raste të ngjashme OSHP më dt. 09.02.2023, ka publikuar në ueb faqen e sa një njoftim për OE se si do të trajtohen në rast se nuk respektohen këto parime dhe nuk mund ta kenë pastaj statusin e palës me interes.

Në kontekstin shpjegimeve si më sipër, Paneli i vuri në zbatim po ashtu nenin 103, të LPP, sipas të cilit, “Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term (“palë e interesuar”) në nenin 4 të këtij ligji”. Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar në këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP. Andaj, operatori ekonomik ankues me rastin e parashtrimit të kësaj ankese nuk ka arritur të dëshmoi interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit. Andaj, paneli shqyrtues operatorin ekonomik ankues për këtë aktivitet të prokurimit e sheh si palë pa interes juridiko material, konform nenit 4, paragrafi 1.26 i LPP-së, i cili citon: *“Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar.”* Këtë vendim Paneli shqyrtues e mbështet edhe tek neni 31, paragrafi 2 i Rregullores së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit nr.83/20.

Rrjedhimisht, paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”. Paneli mendon se edhe nisur nga fakti se çdo vendim ndryshe nga ky do të ishte jo meritore dhe jo parimor që të dëmtohet komplet një proces i një aktiviteti të prokurimit për shkak të një OE i cili është i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Kthimi i një aktiviteti të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur në konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - MALSIAJ COMPANY SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: